



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.87/ 6 prot.

Datë 08.02.2024

**V E N D I M**

**Nr.154/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.02.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “T & XH” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-88456-11-21-2023, me objekt “Rikualifikim i ambienteve të jashtme” me fond limit 22,0000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor, SH.A Porti Detar Sarandë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “T & XH” SHPK me NIPT L72121504I dhe adresë: Rr. “Kongresi i Manastirit”, ZK 8514, Pasuria nr. 1/432, Hyrja-1 (Prane Kapedanit).
- Autoriteti Kontraktor:** SH.A Porti Detar Sarandë me adresë: Rruga “Mitat Hoxha”, Lagjja nr.4, Sarandë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

*Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-88456-11-21-2023, me objekt “Rikualifikim i ambienteve të jashtme” me fond limit 22,0000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor SH.A Porti Detar Sarandë.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05.01.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “ASI 2” SHPK	16.292.372 lekë	skualifikuar
- BOE “Neal-86”-“KUPA” SHPK	16.453.873 leke	skualifikuar
-“AURUM CONSTRUCTION” SHPK	18.996.4063 lekë	kualifikuar
- “B-93 II” SHPK	19.738.517 lekë	skualifikuar
- “FLED” SHPK	18.473.621 lekë	skualifikuar

- “BOE “ILIRIA/D” – “LIS KONSTRUKSION” SHPK	16.542.865 lekë	skualifikuar
- “INA” SHPK	21.327.789 lekë	skualifikuar
- “Jody Kompany” SHPK	16.496.497 lekë	skualifikuar
- “T&XH” SHPK	17.901.909 lekë	skualifikuar

Operatori ekonomik ankimes “T & XH” SHPK, rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

*“Subjekti T&XH shpk nuk permbush piken 2.3.9 te DST, konkretisht: • Nuk ka paraqitur certifikatën CE ose raporte testimi për bojën bikomponente të vijëzimit, i cili duhet të vertetohet Standardin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “Materialet për vijëzimet horizontale në rrugë-Metodat laboratorike në identifikim”, ose ekuivalentin e tij.”*

II.3. Në datën 09.01.2024, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton, se është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 15.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 87 prot., e operatorit ekonomik “T&XH” SHPK, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, konkretisht duke pretenduar:

*“Në dokumentet e tenderit të kësaj procedure, në Shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, nga ana e entit tuaj kontraktor është vendosur kriteri kualifikues, si më poshtë:*

*2.3.9 Operatori ekonomik ofertues: për materialet e pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht, standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Certifikatë Konfirmimit CE për produktet ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara.*

*Në dokumentet e tenderit Shtojca 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, nga ana e entit tuaj kontraktor janë dhënë specifikimet teknike të projektit që prokurohet si më poshtë:*

Shtojca 5.

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Të dhënat teknike të punëve objekt - prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjisllacionin në fuqi.*

*SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose , eliminimin, e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm për raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e miftueshme e saktë apo e kuptueshme e*

*përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Skicimet, parametrat teknike etj:*

*Format PDF ne Spe APP*

*Specifikimi i Materialeve:*

*Format PDF në SPE APP*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

*Format PDF në SPE APP “*

*www.app.gov.al*

**LIDHUR ME KETO PERCAKTIME TË SHTOJCES 5 VEREJME SE NE SPE NE FORMATIN “PDF” JANE NGARKUAR NGA ANA E ENTIT TUAJ KONTRAKTOR KETO DOKUMENTE SI ME POSHTE:**

- 1. Dokumenti i emertuar “RELACIONI TEKNIK (1) pdf”*
- 2. Dokumenti i emertuar “4 P verbali ArgumkKritere (1 1) pdf”*
- 3. Dokumenti i emertuar “PREVENTIVI MEMEMC (1) pdf”*
- 4. Dokumenti i emertuar “ANALIZA (1) pdf”*
- 5.. Dokumenti i emertuar “PROJEKTI FINAL pdf”*
- 6. Dokumenti i emertuar “GRAFIK pdf”*
- 7. Dokumenti i emertuar “specifikimet teknike (1) pdf”*
- 8. Dokumenti i emertuar “4 DST-RIKUALIFIKIMI pdf”*

*Ne secilin prej ketyre dokumentave te siperpermendur dhe te publikuar nga ana e entit tuaj kontraktor ne permabitjen e tyre (per me teper edhe dokumenti i emertuar “specifikimet teknike (1) pdf”) qe boja e vijeimit qe do te perdoret te jete e CERTIFIKUAR CE dhe per me teper qe te plotesoje STANDARTIN SHQIPTAR SSH EN 12802:2011.*

*PRA SI KONKLuzion NE SHTOJCEN 5 TE DOKUMENTEVE TË TENDERIT TE PUBLIKUARA NUK ESHTË PERCAKTUAR NE SHTOJCEN 5 (SHTOJCE NE TE CILEN ME LIGJ ENTI PROKRUES KA DETYRIMIN QE TË VENDOSE SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE T’JA BEJE TE DITURA OFERTUESIT) QE BOJA E VIJEZIMIT DUHET TE JETE E CERTIFIKUAR CE DHE QE NJEKOHESISHT DUHET TE PLOETSOJE STANDARDIN SHQIPTAR SSH EN 12802:2011.*

*Ne kriterin e pikes 2.3.9 nga enti juaj eshte kerkuar qe per MATERIALET E PASQYRUARA NE SHTOJCEN 5 duhet te paraqese DEKLARATË/ÇERTIFIKATË KONFORMITETI CE OSE RAPORTE TESTIMI TË LËSHUARA NGA ORGANIZMA TË NOTIFIKUAR EUROPIAN ORGANIZMA TESTUES TË AKREDITUAR, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara.*

*Pra komania jone e ka paraqitur DEKLARATEN E KONFORMITETIT te dates 09.03.2023 te leshuar nga kompania greke prodhuese e bojes se vijeimit te rrugeve VECHRO S.A e cila deshmon se ky produkt permbush kerkesat e DIREKTIVES NEUROPIANE 761721 EEC, duke e plotesuar kete kriter kualifikues, NDONESE SIKURSE PARASHTRUAM ME SIPER NGA ANA E ENTIT TUAJ KONTRAKTOR NE SHTOJCEN 5 TE DOKUMENTEVE TE*

*TENDERIT, NUK ESHTË PERCAKTUAR QË BOJA E VIJËZIMIT TË JETË E CERTIFIKUAR CE DHE QË NJEKOHESISHT TË PLOTESOJE STANDARDIN SHQIPTAR SSH EN 12802:2011.NE PERFUNDIM I BEJME ME DIJE ENTIT PROKURUES SE KOMISIONI I VLERESIMIT TË OFERTAVE NE VLERESIMIN E OFERTES SE KOMPANISE SONE ESHTË MBESHËTETUR MBI NJE KRITER TË PAKERKUAR DHE PER KETE ARSYE DUHET QË TA KUALIFIKOJE OFERTEN TONE.”*

*Per sa me siper kerkojme:*

*1.Pezullimin e tenderit.*

*2Kualifikimin e ofertes se kompanise tone “T &XH” shpk, si oferte qe e plotesor kriterin kualifikues te pikes 2.3.9 te Shtojces 7 te DST-ve.”*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.87/2, datë 16.01.2024, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu, nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik “T&XH” SHPK është dorëzuar në autoritet kontraktor më datë 15.01.2024, me nr. 44 prot.

II.7. Me shkresën nr. 53 prot., datë 18.01.2024, protokolluar me tonën me nr.87/3 prot., datë 19.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “T&XH” SHPK, në të cilin konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën, duke arsyetuar si më poshtë:

*“[...]*

- Me administrimin e ankesës 44 prot 15.01.2024 me anë të Urdhrit Nr.9 Datë 15.01.2024 të titullarit të Entit Kontraktor u bë pezullimi I procedurës si dhe me anë të Urdhrit Nr.10 Datë 16.01.2024 u bë ngritja e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesës.*
- Nga ana e komisionit u verifikua se ankesa është paraqitur sipas formatit të miratuar në dokumentet standarde të tenderit si dhe është kryer pagesa e faturës nga OE datë 11.01.2024.*
- Per sa i takon pretendimit të OE se në dokumentacionin e publikuar për tenderin në fjalë nuk është përcaktuar që boja e vijëzimit që do të përdoret të jetë e certifikuar CE dhe të plotësojë Standardin Shqiptar SSHEN 12802:2011 sqarojmë se:*
- Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit për përmbushjen e Kapacitetit Teknik kërkesën për kualifikim 2.3.9 me përmbajtje:*

*Operatori ekonomik ofertues për materialet e pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Certifikatë Konfirmimit CE për produktet ose raporte testimi të*

*lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara*

*Në shtojcën 5 të ngarkuar dy here ne SPE me emërtesën “shtojca nr.5” ne faqen nr.3 dhe nr.4 te saj janë ngarkuar:*

### **BOJË BIKOMPONENTE VIJËZIMI**

*Boja të jetë me përbërje metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA), e cila shërben për përdorim të jashtëm, në sipërfaqe rrugësh, parkingje, sheshe sportive etj. Kjo lloj rezine është e përshtatshme posaçërisht për të realizuar një tharje sa më të shpejtë për shkak të natyrës së aplikimit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë. Karakteristikat Teknike:*

*- Natyra e lidhësit bazë: Rezinë metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA) - Viskoziteti:  $100 \pm 20$  KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente - Tharja:  $\leq 30$  min në  $25^{\circ}\text{C}$  - Pesha specifike:  $1.6 \pm 0.2$  kg/litër - Norma e hapjes:  $\leq 1.5$  kg/m<sup>2</sup> (spesor 1mm) - Pesha specifike:  $1.6 \pm 0.2$  kg/litër - Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK - Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 50C - 300C - Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi - Paketimi: Në kova plastike ose metalike 3-20 litra*

*STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon: Rezultati për identifikimin e përbërësve të lidhësit bazë dhe rezultati për vlerën e peshës specifike duhet të jenë provuar me anë të metodës së testimit në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodat laboratorike për identifikim” ose ekuivalentin e tij*

*Referuar procesverbalit të mbajtur nga ana e KSHA-së, me nr. prot 52, datë 18.01.2024, vlerësohet se:*

- 1. Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.*
- 2. Dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit përmban të dhënat dhe kërkesat që duhet të plotësojë produkti me emërtesë Bojë bikomponente vijëzimi në Shtojcën nr.5.*

*Bashkëlidhur : foto te printuara nga sistemi SPE (1 flete) dhe Shtojca nr.5 (4 flete).*

II.8. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

## **III**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “T & XH” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “

“1. “Subjekti T&XH ShPK nuk permbush piken 2.3.9 të DST, konkretisht: • Nuk ka paraqitur certifikatën CE ose raporte testimi për bojën bikomponente të vijëzimit, i cili duhet të vertetojë Standardin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “Materialet për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodën laboratorike të identifikimit”, ose ekuivalentin e tij.”KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.9, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues për materialet e pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konfirmimit CE për produktet ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara.

III.1.2. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” për bojën bikomponente vijëzim, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

### **BOJË BIKOMPONENTE VIJËZIMI**

Boja të jetë me përbërje metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA), e cila shërben për përdorim të jashtëm, në sipërfaqe rrugësh, parkingje, sheshe sportive etj. Kjo lloj rezine është e përshtatshme posaçërisht për të realizuar një tharje sa më të shpejtë për shkak të natyrës së aplikimit. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë. Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit bazë: Rezinë metil metakrilati (Methyl Methacrylate MMA) - Viskoiziteti:  $100 \pm 20$  KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente - Tharja:  $\leq 30$  min në  $25^{\circ}\text{C}$  - Peshë specifike:  $1.6 \pm 0.2$  kg/litër - Norma e hapjes:  $\leq 1.5$  kg/m<sup>2</sup> (spesor 1mm) - Peshë specifike:  $1.6 \pm 0.2$  kg/litër - Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK - Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 50C - 300C - Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi - Paketimi: Në kova plastike ose metalike 3-20 litra

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon: Rezultati për identifikimin e përbërësve të lidhësit bazë dhe rezultati për vlerën e peshës specifike duhet të jenë provuar me anë të metodës së testimit në përputhje me Standartin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodën laboratorike për identifikimit” ose ekuivalentin e tij

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratën e konformitetit të kompanisë Vechro Paints të datës 09.03.2022 të shoqëruar me vërtetim përkthimi datë 08.12.2023, me nr. REP 3103, me përmbajtje si vijon: “Ne,

*Vechro S.A, deklarojmë, se jemi në përputhje me Direktivën e Këshillit (76/211/EEC) të datës 10 janar 1976, mbi përfrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përgatitjen-sipas peshës ose vëllimit të disa produkteve të parapaketuara.”*

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 4, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti



kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimes, me qëllim përmbushjen e kriterit “2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues për materialet e pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë Deklaratë/Certifikatë Konfirmimit CE për produktet ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara.*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.3 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “T & XH” SHPK, lidhur me përmbushjen nga ana e tij të kriterit më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “T & XH” SHPK nuk e ka përmbushur kriterin e mësipërm. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik për përmbushjen e kriterit më sipër, konkretisht deklarata e konformitetit e kompanisë Vechro Paints e datës 09.03.2022, e shoqëruar me vërtetim përkthimi datë 08.12.2023, me nr. REP 3103, me përmbajtje si vijon: “*Ne, Vechro S.A, deklarojmë se jemi në përputhje me Direktivën e Këshillit (76/211/EEC) të datës 10 janar 1976, mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përgatitjen-sipas peshës ose vëllimit të disa produkteve të parapaketuara.*”, të cilës ankimesi i referohet si dokumenti që ka ngarkuar në sistem për përmbushjen e kriterit më sipër, për materialin bojë bikomponente vijëzimi, nuk rezulton që kjo deklaratë të ketë të përcaktuar në asnjë pikë të përmbajtjes së saj plotësimin e standardit SSH EN 12802:2011 “Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodat laboratorike për identifikim” ose ekuivalentin e tij, ashtu sikurse autoriteti kontraktor ka kërkuar në specifikimet teknike për standartin teknik që duhet të plotësojë ky lloj materiali. Ndryshe nga sa pretendon ankimesi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë në kriter, që për materialet e përcaktuara në specifikimet teknike, ku ndër to bën pjesë edhe boja bikomponente e vijëzimit, duhet të paraqitet Deklaratë/Certifikatë Konfirmimit CE për produktet ose raporte testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve teknike të kërkuara. Referuar sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik “T & XH” SHPK nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentet e tenderit konkretisht në pikën 2.3.9 të kapacitetit teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit

*të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Akoma më tej , kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”*

KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “T & XH” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “T &XH” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-88456-11-21-2023, me objekt “Rikualifikim i ambienteve të jashtme”, me fond limit 22,0000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.12.2023, nga autoriteti kontraktor, SH.A Porti Detar Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “T & XH” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

